



**TV Syri Vision  
Zeqir Haxhija  
Pronar  
Gjakovë**

**Rasti Nr. 2018/178  
Ref:1812/1329/KPM/mf**

### VENDIM

#### **Lidhur me Rastin Nr. 2018/178 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për TV Syri Vision (“Pala Përgjegjëse”)**

---

#### Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) me datën 28 maj 2013 ka nxjerrë Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale KPM 2013/01. Me këtë rregullore është përcaktuar mënyra e kategorizimit, sinjalizimit dhe zgjedhjes së kohës së transmetimit të programeve të cilat mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin fizik, mental, emocional dhe moral të fëmijëve dhe të miturve.
2. KPM me datat 22 deri më 24 gusht 2018 ka bërë monitorimin e programeve të Palës Përgjegjëse, për të vlerësuar pajtueshmërinë me Rregulloren KPM 2013/01.
3. KPM, në bazë të Raportit të monitorimit të datës 6 shtator 2018 ka gjetur se Pala Përgjegjëse filmat e transmetuar nuk i ka kategorizuar dhe i ka transmetuar në termine kohore jo të përshtatshme për fëmijë dhe të mitur, po ashtu nuk i ka paralajmëruar në fillim me sinjal akustik apo tekstual.
4. KPM, pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 8 tetor 2018 i ka dërguar Palës Përgjegjëse Njoftim për Shkelje me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe i ka kërkuar të veprojë në pajtim me Rregulloren KPM-2013/01, në të kundërtën do t'i rekomandojë Komisionit të KPM-së të ndërmarrë masa ligjore ndaj Palës Përgjegjëse në pajtim me nenin 30 të Ligjit të KPM-së.
5. KPM ka bërë edhe një monitorim të dytë për të parë nëse pas Njoftimit për shkelje Pala Përgjegjëse ka ardhur në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2013/01. Monitorimi është bërë për datat 21 deri 23 tetor 2018 dhe në bazë të Raportit të monitorimit të datës 30 tetor 2018 është gjetur se Pala Përgjegjëse ka vazhduar të jetë në shkelje të Rregullores KPM-2013/01.

## Analiza Ligjore

6. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 6, Koha e transmetimit, paragrafi 2 dhe 4 të Rregullores KPM-2013/01.

Neni 6, paragrafi 2, i Rregullores KPM-2013/01, përcakton se:

*“Transmetimi i programeve që i takojnë kategorisë së dytë mund të bëhet prej orës 15:00 deri në orën 06:00.”*

Neni 6, paragrafi 4, i Rregullores KPM-2013/01, përcakton se:

*“Transmetimi i programeve që i takojnë kategorisë së katërt mund të bëhet prej orës 24:00 deri në orën 05:00.”*

Komisioni në bazë të raporteve të monitorimit ka gjetur se Pala Përgjegjëse gjatë ditëve të monitoruara ka transmetuar dhe reprizuar filma, të kategorizuara si përmbajtje programore 10 + dhe 18+, në termine kohore jo të përshtatshme për fëmijë dhe të mitur. Filmi “How to lose a guy in 10 days” është transmetuar nga ora 11:41 dhe filmi “Haeven” është transmetuar rreth orës nga ora 11:44, filma këta të vlerësuar nga Departamenti i Monitorimit dhe Analizave si filma që i takojnë kategorisë së dytë. Filmi “Goyas Geister” është transmetuar nga ora 23:30 dhe 03:19, filmi “House of Flying Daggers” është transmetuar rreth orës 23:30, filma këta të vlerësuar nga Departamenti i Monitorimit dhe Analizave si filma që i takojnë kategorisë së katërt. Sipas Rregullores KPM-2013/01 programet e kategorisë së dytë mund të transmetohen prej orës 15:00-06:00 dhe programet e kategorisë së katërt mund të transmetohen prej orës 24:00-05:00.

7. Komisioni gjithashtu ka gjetur se Pala Përgjegjëse filmat e transmetuar nuk i paralajmëron në fillim në mënyrë akustike dhe verbale, duke bërë shkelje të nenit 7, Shenjat dhe piktogramet, paragrafi 1 dhe 3.

Neni 7, paragrafi 3, i Rregullores KPM-2013/01, përcakton se:

*“Para fillimit të programit dhe pas çdo ndërprerje të programit bëhet paralajmërim verbal dhe akustik.”*

8. Komisioni ka gjetur se Pala Përgjegjëse edhe pas Njoftimit për shkelje të dërguar nga KPM në të cilin i është kërkuar që të veprojnë në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2013/01 ka dështuar të veprojnë në pajtim me Rregulloren KPM-2013/01.
9. Komisioni duke u bazuar në faktet e lartpërmendura ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 6, paragrafi 2 dhe 4 dhe nenit 7 paragrafi 3, të Rregullores KPM-2013/01.

